



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura V

Sesioni pranveror

Komisioni për Legjislacion, Mandate,
Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen
e Agjencisë Kundër Korrupsionit

Mbledhja nr. 73

Prishtinë, më 22.6.2016, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla S 2

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Albulena Haxhiu, Selvije Halimi, Danush Ademi, Agim Aliu, Nezir Çoçaj, Armend Zemaj dhe Milena Miliçević.

Munguan: Agim Ademaj, Doruntinë Maloku, Donika Kadaj-Bujupi dhe Valdete Bajrami.

Të ftuar dhe pjesëmarrës të tjerë: Fjolla Uka dhe Genc Jaha – KDI, Alma Tafarshiku – EULEX, Dredhëza Ahmeti – Rrokum TV, Taulant Osmani – Jeta në Kosovë, Egzon Pacolli praktikant.

Nga Stafi i Komisionit: Visar Krasniqi, Mirlinda Kolgeci dhe Fatbardha Boletini.

Mbledhjen e kryesoi, Albulena Haxhiu, kryetare e Komisionit.

Rendi i ditës:

Intervistimi i kandidatëve për anëtar të Këshillit Gjyqësor të Kosovës.

Kryetarja konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së rendit të ditës.

Kryetarjai njoftoi të pranishmit për përgatitjet e bëra para fillimit të intervistimit. Ajo tha se tashmë kemi praktikë sesi t'i bëjmë intervistimet tilla, ku secili kandidat do të ketë 15 minuta në dispozicion për përgjigje. Po ashtu, do të jenë tri pyetje, një do të parashtrohet nga kryetarja e

Komisionit, një nga nënkryetarja SelvijeHalimi dhe një pyetje nga deputetiArmend Zemaj. Pyetjet do të jenë të njëjta, për secilin kandidat. Më tutje, Komisioni vendosi që mediat të marrin pamjet nga takimi i Komisionit, por jo edhe të qëndrojnë gjatë gjithë kohës. Kurse, për prezencën e shoqërisë civile, u vendos që ata mund të qëndrojnë gjatë intervistimit.

- Pyetja nga kryetarja e Komisionit, Albulena Haxhiu, ishte: A jeni në dijeni me ndryshimet e reja ligjore, që kanë të bëjnë me përbërjen e KGJK-së dhe kujt i raporton KGJK-ja?
- Pyetja nga nënkryetarja SelvijeHalimi ishte: Cilat janë dobësitë që ju keni vërejtur në KGJK, dhe në rast se zgjidheni, cila do të ishte qasja juaj që ky institucion të jetë më funksional?
- Pyetja nga deputeti Armend Zemaj ishte: Sa jeni në dijeni me procesin epërzgjedhjes së gjyqtarëve nga komiteti serb, dhe në rast se zgjidheni anëtar i KGJK-së, cila do të ishte qasja juaj në këtë proces?

Komisioni, pas shqyrtimit të të gjitha çështjeve që kishin të bënin me përgatitjet e intervistimit të kandidatëve, vlerësoi se janë bërë të gjitha përgatitjet për t'ia filluar punës.

Intervistimi i kandidatëve filloi në orën 11:10. Së pari u intervistua kandidati NenadLaziqdhe pas tij,BogoljubStaletoviç.

Komisioni, pas përfundimit të intervistimit të 2 kandidatëve dhe duke u bazuar në vlerësimin e anëtarëve të Komisionit, pra në poentimin e secilit kandidat, rezultoi se kandidatiNenadLaziqu vlerësua me 48 pikëdhe BogoljubStaletoviç,me 45 pikë.

Kryetarja konstatoi se Komisioni, në pajtim nenit 5 A të Ligjit nr. 05/L -033, për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-223 për Këshillin Gjyqësor të Republikës së Kosovës, zhvilloi proceduarat për përzgjedhjen e kandidatit për anëtar të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, dhe vendosi që Kuvendit t'ia paraqesë këtë:

R e k o m a n d i m

I. Irekomandohen Kuvendit për votim të kandidatëve për anëtarë të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, siç përcaktohet me nenin 108, paragrafi 6, nënparagrafi 3 të Kushtetutës, të radhitur sipas rezultateve të poentimit, si vijon:

1. NenadLaziq – 48 pikë, dhe
2. BogoljubStaletoviç– 45 pikë.

II. Kuvendi, prej 2 (dy) kandidatëve të propozuar për anëtar të Këshillit Gjyqësor, do të zgjedhë njërin nga kandidatët.

III. Votimi i kandidatëve për anëtar të Këshillit Gjyqësor, bëhet me votim të fshehtë.

IV. Mandati i anëtarit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës është 5 (pesë) vjet.

Mbledhja përfundoi në orën 11:40.

E përgatiti:

Stafi mbështetës i Komisionit.

Kryetarja e Komisionit,

Albulena Haxhiu